

Aksidentet rrugore

Qershor 2017

Tiranë, më 19 Korrik 2017: Në muajin Qershor 2017 numërohen 185 aksidente rrugore. Në krahasim me Qershor 2016, numri i aksidenteve është rritur me 2,2 %.

Numri i të aksidentuarve është 245 persona nga 257 që ishte një vit më parë.

Në gjashtëmujorin e parë 2017, numri i të aksidentuarve është ulur 4,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Numri i personave të vdekur gjatë muajit Qershor 2017 është 12. Krahasuar me mesataren e personave të vdekur gjatë vitit 2016, ky numër është ulur me 46,4 %.

Në Qershor, aksidentet rrugore, në 73,0 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup mosha 16 – 25 vjeç duke zënë 24,3 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke u rritur me 66,7 %, krahasuar me një njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në gjashtëmujorin e parë 2017, aksidentet rrugore të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit zënë 79,9 % të rasteve. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup mosha 25 – 35 vjeç, duke zënë 28,3 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke shënuar ulje 9,3 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Qershor 2017, numri të aksidentuarve për 100.000 banorë ishte afërsisht 8 persona. Krahasuar me mesataren e vitit 2016, ky numër u rrit me 5,8 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Qershor 2013 - Qershor 2017



Tab. 1 Aksidentet rugore, Qershor 2017

Periudha	Aksidente	Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Qershor - 2016	181	5	18	84	150
Qershor - 2017	185	4	8	65	168
Ndryshimi vjetor (%)	2,2	-20,0	-55,6	-22,6	12,0
Janar - Qershor 2016	928	18	112	355	772
Janar - Qershor 2017	899	20	85	337	763
Ndryshimi vjetor progresive (%)	-3,1	11,1	-24,1	-5,1	-1,2

Tab. 2 Aksidentet rugore sipas përdoruesve të rugës, Qershor 2017

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur sipas	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Qershor - 2016	154	27	19	4
Qershor - 2017	135	50	7	5
Janar - Qershor 2016	792	136	105	25
Janar - Qershor 2017	718	181	84	21

Tab. 3 Aksidentet rugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit, Qershor 2017

Periudha	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25 - 35 vjeç	35 - 45 vjeç	45 - 60 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Qershor - 2016	0	27	59	32	42	11	10
Qershor - 2017	1	45	43	30	42	14	10
Janar - Qershor 2016	4	174	280	147	189	66	68
Janar - Qershor 2017	4	214	254	138	170	67	52

Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve, Qershor 2017

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Qer-16	Qer -17	Qer-16	Qer -17	Janar-Qer 2016	Janar-Qer 2017	Janar-Qer 2016	Janar-Qer 2017
Shqipëria	181	185	23	12	928	899	130	105
Tiranë	68	75	6	4	338	367	35	22
Durrës	23	26	3	0	139	122	20	9
Shkodër	9	5	2	1	53	26	11	11
Elbasan	9	21	1	1	64	81	6	11
Fier	8	9	0	1	58	47	10	14
Vlorë	8	9	2	1	39	50	7	7
Korçë	22	11	4	1	71	40	12	7
Lezhë	21	19	3	2	94	91	15	13
Berat	4	4	0	0	26	23	3	0
Kukës	3	0	1	0	20	19	2	2
Dibër	4	3	0	0	14	17	3	0
Gjirokastër	2	3	1	1	12	16	6	9

Përkufizime

Aksidente: Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.